



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura IV**

Kryesia e Kuvendit

P-062

Prishtinë, më 30 prill 2012, në orën 15:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË TË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 30 PRILL 2012**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Glauk Konjufca, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare:** Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Burim Ramadani, Myzejene Selmani, Sasha Millosavljeviq dhe Albert Kinolli.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit:** Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Shefqet Rexhepi;

**Nga OSBE-ja,** Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

### **R e n d d i t e**

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 17 dhe 18 prill 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

#### **1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 17 dhe 18 prill 2012**

Procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 17 dhe 18 prill 2012, u miratuan pa vërejtje.

#### **2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi t'i mbajë dy mbledhje plenare në pjesën e parë të këtij muaji.

**Më 3 maj 2012, me këtë**

### **R e n d d i t e**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Debat parlamentar lidhur me çështjen e personave të zhdukur,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat personale,

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të akcizave në Kosovë,
10. Shqyrtimi i vendimit të presidentes së Kosovës për kthimin në shqyrtim të ligjit nr. 04/L-084, për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

**Më 10 maj 2012, me këtë**

### *R e n d i t e*

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Interpelancë me zëvendëskryeministren, Edita Tahiri lidhur me fatin e të zhdukurve në raport me bisedimet me Serbinë, në Bruksel, sipas kërkesës së Grupit të deputetëve nënshkrues,
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011,
6. Shqyrtimi i Raportit të punës të Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2011,
7. Shqyrtimi i Raportit të punës të Komisionit të Pavarur të Mediave, për vitin 2011,
8. Shqyrtimi i Raportit të punës të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, për vitin 2011,
9. Shqyrtimi i Raportit të punës të Radio Televizionit të Kosovës, për vitin 2011,
10. Shqyrtimi i Propozimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore,
11. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës me emërimin e anëtarit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës,
12. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit ad hoc për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, për afat shtesë.

Gjithashtu, u konkludua se rendi i ditës, për mbledhjen plenare të datës 10 maj 2012, mund të plotësohet edhe me ndonjë pikë shtesë, nëse i plotëson kushtet për procedim në seancë.

### **3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave:**

#### **3.1 Rekomandimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për debat parlamentar lidhur me çështjen e personave të zhdukur**

Kryesia vendosi që debati parlamentar lidhur me çështjen e personave të zhdukur, të radhitet në rend dite të mbledhjen plenare, më 3 maj 2012.

### **3.2 Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Radio Televizionit të Kosovës për mbulimin e shpenzimeve të auditimit të performancës së RTK-së**

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e Komisionit të lartcekur, nxori këtë

#### **P Ë R F U N D I M**

1. Kërkohe nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, që në bazë të nenit 3.7 të ligjit nr. 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës, të bëjë auditimin e performancës së Radio Televizionit të Kosovës, për vitin 2011 dhe raportin e auditimit t'ia dërgojë Kuvendit.
2. Kërkohe nga Radio Televizioni i Kosovës, që në afatin sa më të shkurtër të mundshëm, t'ia Dërgojë Kuvendit të Republikës së Kosovës, listën e pagave të punësuarve në Radio Televizionin e Kosovës.

### **3.3 Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e institucionit të Avokatit të Popullit, për caktimin e pagës së zëvendësavokatëve të popullit, si dhe njoftimi me reagimin e Avokatit të Popullit lidhur me rrjedhën e mbledhjes së Komisionit për Buxhet dhe Financa**

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e cekur më lart, nxori këtë

#### **P Ë R F U N D I M**

1. Qeveria e Kosovës t'i ekzekutojë pagat për pesë zëvendësavokatët e popullit në nivelin e pagës të përcaktuar me Ligjin e buxhetit të Republikës së Kosovës, për vitin 2011 dhe Ligjin e buxhetit të Republikës së Kosovës, për vitin 2012.
2. Kërkohe nga Qeveria e Kosovës që ta përshpejtojë procedimin e Projektligjit për pagat e funksionarëve publik, për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Gjithashtu, Kryesia, u njoftua me reagimin e Avokatit të Popullit lidhur me rrjedhën e mbledhjes së Komisionit për Buxhet dhe Financa, të mbajtur më 17 prill 2012.

### **3.4 Njoftimi i Komisionit për Legjislacion lidhur me emërimin e anëtarit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës**

Kryesia u njoftua me qëndrimin e Komisionit për Legjislacion lidhur me kriterin e moshës së një kandidati të propozuar për t'u emëruar anëtar i Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës.

Kryesia vendosi që Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës, ta radhisë për shqyrtim në mbledhjen plenare të radhës, më 10 maj 2012.

### **3.5 Kërkesa e Komisionit ad hoc për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, për afat shtesë**

Kryesia vendosi që kërkesën e cekur më lart ta radhisë në rend dite të mbledhjes plenare, më 10 maj 2012.

### **3.6 Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës, për vitin 2011**

Kryesia, pasi e shqyrtoi Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës, për vitin 2011, mori këtë

#### **V E N D I M**

Miratohet Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2011, sipas pasqyrave të paraqitura nga Komisioni për Buxhet e Financa dhe administrata e Kuvendit.

### **3.7 Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel**

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartcekur, mori këtë

#### **V E N D I M**

1. Lejohet udhëtimi i Kryetarit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport dhe Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Idriz Vehapi, që të marrë pjesë në vazhden e takimeve të rregullta për stabilizim-asocim, të organizuar nga Ministria e Integritimeve Evropiane, në Bruksel, prej datës 2-5 maj 2012.

2. Shpenzimet e akomodimit i mbulon Ministria e Integritimeve Evropiane, ndërsa shpenzimet e udhëtimit, ushqimit, mëditjeve, për të lartpërmendurin, në paragrafin një (1) të këtij vendimi, mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

### **3.8 Njoftimi i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Gjermani**

Kryesia u njoftua me vizitën e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, të realizuar në Gjermani, prej 25 deri më 31 mars 2012.

### **3.9 Njoftim i delegacionit të Kuvendit të Kosovës lidhur me pjesëmarrjen në konferencën “Mbrojtje e Zgjuar” që u mbajt në Tiranë**

Kryesia u njoftua për pjesëmarrjen e delegacionit të Kuvendit të Kosovës në konferencën “Mbrojtje e Zgjuar”, të realizuar në Tiranë, prej 23 deri më 24 prill 2012.

#### **Pikatë shtesë:**

#### **1. Kërkesa e Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për lejimin e shfrytëzimit të mjeteve buxhetore, të ndara nga Qeveria e Kosovës**

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lart cekur, nxori këtë

### **P Ë R F U N D I M**

Ngarkohet Administrata e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të kërkojë nga Ministria e Financave, që në kuadër të Kodit të Buxhetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të hapë një **nënkod** për destinimin e mjeteve të ndara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në vlerë prej 25.000,00 (njëzetepesë mijë euro), për Komisionin Kushtetues, për punën në mandatin e tretë, që ka të bëjë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

#### **2. Raporti i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës lidhur me vendimin e presidentes për kthimin e Ligjit për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës**

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me raportin e cekur më lart, vendosi që atë ta radhisë në rend dite të mbledhjes plenare, më 3 maj 2012.

**Kryetari** e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **16:15** minuta.

Kryetari i Kuvendit

**Jakup KRASNIQI**

Procesverbalin e hartoi:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale